# DËSHMI ARKIVI

**A-472853**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Rangnick e sheh Kosovën kundërshtare shumë të vështirë |
| ADRESA | `https://www.koha.net/futboll/rangnick-e-sheh-kosoven-kundershtare-shume-te-veshtire` |
| BURIMI | koha.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 27 shtator 2026, 00:33:15 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 26 shtator 2026, 15:04:47 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `2a4b144a1ffd8742daeeec855e8b80842e7a9880f55a9cdfa6518d443873eb59` |
| TEKSTI | `4d1846b85cba310868d0f838daad1d93a5a70d5fbd44bc84c86ac1699dafa416` |
| PAMJA | `ef9206d662db55e4561cab60216b51c5e4ca90595eb82421a27ac0b4a0340980` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `292639d8af59c516530c5b7eadeafb1e11a2c77ff13706e8a8b448c84a036faa` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `b10c494828e869d78c4964825696e8a5573bfada17b69bc959e4e0f8872354e0` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/292639d8af59c516530c5b7eadeafb1e11a2c77ff13706e8a8b448c84a036faa`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Mbështete KOHËN. Ruaje të vërtetën Kontribuo → Letër lexuesit

FUTBOLL

# Rangnick e sheh Kosovën kundërshtare shumë të vështirë



26 shtator 2026 17:04

Shpërndaje në:

Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalin tonë zyrtar në Viber

Përzgjedhësi Ralf Rangnick i Austrisë synon fitore përballë Kosovës që drejtohet nga miku i tij, Franco Foda. Rangnick dhe Foda kanë pranuar në intervistat e dhëna më herët se kanë marrëdhënie shumë të mirë mes vete. Por, të dielën nga ora 18:00 në stadiumin "Ernst Happel", secili prej tyre kërkon pikët e plota. Si Austria ashtu edhe Kosova, e nisën kampanjën e pestë të Ligës së Kombeve me fitore. Austria fitoi 3:1 në Linz ndaj Izraelit, ndërsa Kosova në Prishtinë e mposhti Irlandën, 1:0.

Përzgjedhësi Rangnick pret ndeshje edhe më të vështirë të dielën mbrëma në Vjenë.

"Pres që ndeshja të jetë edhe më e vështirë sesa ajo ndaj Izraelit. Ende nuk mund të them se cila është kundërshtare më e fortë. Kosova e meritoi fitoren ndaj Irlandës dhe ne po përgatitemi për një kundërshtare që synon shumë", ka deklaruar trajneri Rangnick.

Rangnick beson se ndeshja do të zhvillohet me atmosferë të bukur. Të gjitha biletat për këtë ndeshje janë shitur. Kosova do ta ketë mbështetjen e madhe po ashtu.

"Duam ta fitojmë ndeshjen e dytë në shtëpi, para tifozëve tanë në stadiumin që do të jetë plot me tifozë. Nëse e arrijmë këtë, do të ishte pozitive për duelet e ardhshme pasi hyjmë si të parët në grup", ka shtuar tutje tekniku me përvojë.

Austria dhe Kosova i prijnë grupit B3 me nga tri pikë. Kosova viteve të fundit ka shënuar rritje të madhe. Luajti edhe në plejofin për Botërorin 2026 që u organizua në verë. Për rritjen e Kosovës ka folur edhe mesfushori Xaver Schlager. Schlager debutoi tek Austria nën drejtimin e Franco Fodas në vitin 2018.

Edhe



Futboll • 25 sht 2026
Rangnick shpreson në fitore ndaj Kosovës, tregon për takimet me Fodan

"Ai e di se çfarë do, nuk dëshiron të rrezikojë shumë. Është e

Futboll.
Maran e Muçi të kënaqur me fitoren e Shqipërisë

Showbiz.
"Silencio" paralajmëron albumin e ri të grupit "U2" pas nëntë vjetësh

Futboll.
Kampionia e botës e mposht Anglinë

Futboll.
Fitore bindëse e Zvicrës ndaj Maqedonisë së Veriut

Futboll.
Kroacia e nis mbarë, fiton në Çeki

Rajon.
Oligarku ukrainas në arrati merr shtetësinë e Serbisë

rëndësishme të jemi të organizuar kur nuk e kemi topin. Ai padyshim se e ka ndihmuar Kosovën të zhvillohet. Kosova është kundërshtare ndaj së cilës duhet të japim çdo gjë. Ne fokusohemi te vetja dhe duhet të paraqitemi mirë. Nëse e bëjmë këtë, kemi shanse të mira për fitore", theksoi Schlager.

Tek Austria në dyshim për të luajtur është kapiteni Michael Gregoritsch, që pësoi lëndim në nyjën e këmbës në duelin ndaj Izraelit.

Austria më 1 tetor luan në udhëtim tek Irlanda, e më 4 tetor në "Fadil Vokrri" ndaj Kosovës.

#RALF RANGNICK #AUSTRIA

## Artikuj të ngjashëm



**Futboll** • 6 o. më parë
Kosova e motivuar, synon rezultat pozitiv në Vjenë



**Futboll** • 25 sht 2026
Fokusi te ndeshja me Austrinë, Kosova shkon për fitore në Vjenë




**Futboll** • 18 sht 2026
Foda flet për synimet e Kosovës



**Futboll** • 19 mar 2026
Foda tregon për gjasat e Kosovës ndaj Sllovakisë

KOHA

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë origjinal apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësive që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.



Përkthimi i përmbajtjeve në gjuhët tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të ketë gabime!

+383 (0) 38 249 105 / [email protected]

Aneksi i ish-Radio Prishtinës (kati i parë) Xhorxh Bush p.n., 10000 Prishtinë



Shkarkoje aplikacionin e KOHËS
Download on the App Store
GET IT ON Google Play

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.